Anestezia epidurale gjatë lindjes :

disa përgjigje për pyetjet tuaja

Ky dokument ka për qëllim t'ju informojë mbi anestezinë epidurale, avantazhet dhe rreziqet e saj. Ne ju kërkojmë që ta lexoni me kujdes, për të dhënë aprovimin tuaj për këtë procedurë. Ju mund ta kërkoni vetë, nëse do të lindni fëmijë, por edhe mund t'ju propozohet nga ekipi mjekësor. **Shërbimi i anestezisë në Maternitetin "HUG" organizon një kurs informues mbi epiduralin obstetrik, të cilin ne ju rekomandojmë ta ndiqni përpara javës së 38-të të shtatzënisë**. Gjithsesi, nëse ju lindin pyetje të tjera, një mjek anestezist do t'ju japë përgjigjet në varësi të mundësive kohore, duke qenë në dispozicion të mërkurave nga ora 08:00 deri në orën 12:00, ose nëpërmjet numrit të telefonit: 079 553 27 27.

Çfarë është anestezia epidurale?

Është një teknikë që zbatohet nga një mjek anestezist për të lehtësuar dhimbjet gjatë lindjes. Pika e shpimit gjendet ndërmjet dy vertebrave të zonës së mesit. Një kateter (me tub shumë të hollë) futet në zonën epidurale me ndihmën e gjilpërës, që më pas nxirret sërish. Zona epidurale ndodhet përpara membranës që mbështjell lëngun cerebrospinal dhe nervat e palcës kurrizore. Gjatë lindjes, kateteri mundëson administrimin e anestezisë lokale, ka disa medikamente që lehtësojnë dhimbjet që burojnë nga mitra dhe perineumi.

Si realizohet procedura?

Menaxhimi anestetik fillon me:

- Vendosjen e një infuzioni intravenoz (pika-pika)
- Kontrollin e funksioneve tuaja jetësore (zemra, tensioni arterial, frymëmarrja)
- Monitorimi i mirëqenies së bebes suaj.

Mjeku anestezist do t'ju kërkojë që të uleni ose të shtriheni në njërin krah, si dhe të harkoni shpinën duke u kërrusur para. Është e nevojshme që të qëndroni pa lëvizur, në mënyrë që mjeku t'ju njoftojë për fillimin e shtrëngimeve. Një anestezi lokale e lëkurës bëhet për komfortin tuaj (do të ndjeni shpim dhe djeg pak), pastaj identifikohet hapësira epidurale (ndjesi shtypjeje në shpinë). Vendosja e epiduralit zgjat nga 10 në 20 minuta. Pas përgatitjes së përzierjes, fillon injektimi i medikamenteve që qetësojnë dhimbjen. Efekti është i shpejtë: 5 deri në 15 minuta. Anestezia mbahet nën administrim të vazhdueshëm me anestetikë, ju mund t'i administroni vetë dozat suplementare duke shtypur një buton kontrolli.

Të lindësh me, apo pa epidural?

Epidurali nuk është i detyrueshëm, por mund t'ju propozohet për komfortin tuaj. Zgjedhja është e juaja. Në disa raste, epidurali këshillohet për arsye mjekësore, me qëllim lehtësimin e procesit të lindjes. Mjeku obstetër, anestezisti ose mamia mund t'jua rekomandojnë.

A përbën rrezik apo sjell vështirësi përdorimi i epiduralit?

Ndalohet aplikimi: Në rast problemesh me koagulimin e gjakut, infeksioneve të lëkurës, të shpinës apo infeksioneve të përgjithshme.
Vështirësi të mundshme: Në rast deformimi të shtyllës kurrizore (skoliozë) ose në rast mbipeshe, realizimi mund të jetë i vështirë.
Hapësira epidurale përmban gjithashtu enë gjaku dhe ndodh që kateteri hyn në njërën prej tyre. Në këtë rast është e nevojshme që të zëvendësohet.

Cilat janë avantazhet e anestezisë epidurale?

Aktualisht, është **metoda më efikase për të lehtësuar dhimbjet gjatë lindjes** duke ruajtur maksimalisht të gjitha ndjesitë e tjera, si të ushtrimin e forcës dhe dëshirën për të shtyrë. Shumica e pacientëve e përdorin.

Ajo nuk shton mundësitë për ndërhyrje çezariane. Një anestezi e shtyllës kurrizore - injeksion me anestetik drejtpërdrejt në lëngun cerebrospinal – përdoret shpesh së bashku me epiduralin për të mundësuar një efekt më të shpejtë. Nëse aplikohet prerja çezariane, edhe nëse kjo realizohet me urgjencë, anestezia është e nevojshme. Nëse kateteri epidural është i vendosur, ai përdoret dhe ju mund të merrni pjesë plotësisht në lindjen e bebes tuaj. Gjithsesi, në rast anestezie të pamjaftueshme, ose në mungesë të kateterit epidural, mjeku anestezist mund të përdorë një anestezi të shtyllës kurrizore, ose një anestezi të përgjithshme sipas kohës që ka në dispozicion.

Cilat janë disavantazhet ?

Gjatë injektimit:

- Ju mund të ndieni një "dridhje" elektrike në njërën këmbë. Nuk përbën problem, por gjithsesi duhet t'ia thoni këtë anestezistit.
- Gjatë minutave të para mund të vërehet një ulje e përkohshme e tensionit të gjakut që manifestohet me ndjesi dobësie dhe të përziera. Ky efekt korrigjohet nëpërmjet medikamenteve intravenoze dhe nëse është e nevojshme me oksigjen.

Pas injektimit :

- Ulja e ndjeshmërisë në pjesën e poshtme të trupit mund të sjellë humbjen e ndjesisë për nevojën e urinimit, ndaj mund të jetë e nevojshme një ndërhyrje (pa dhimbje) e mamisë.
- Mund të shfaqen ndjesi të kruari, që nuk përbëjnë alergji. Ato trajtohen nëse bëhen shumë të bezdisshme.
- Dhimbjet në vendin e shpimit mund të ndihen për disa ditë. Dhimbja e shpinës është diçka e zakonshme pas lindjes dhe nuk lidhet në mënyrë specifike me epiduralin.

Informoni ekipin mjekësor për çdo siklet apo dhimbje.

Cilat komplikime lidhen me epiduralin?

Relativisht të shpeshta:

- Një anestezi asimetrike apo e pamjaftueshme mund të çojë në heqje të pjesshme të kateterit, apo në një shpim të ri për aplikimin e epiduralit (~5%).
- Epidurali mund të shkaktojë dhimbje koke (~0,5%). Nëse simptomat vazhdojnë, mjeku anestezist do t'ju japë një trajtim specifik në ditët në vazhdim.
- Dridhje përgjithësisht të buta mund të shfaqen me, apo edhe pa aplikimin e anestezisë epidurale.

Të rralla :

- Dëmtime të përkohshme neurologjike (< 0,1%), të cilat zhduken në më pak se 6 muaj, si ndjesi shpimi nga gjilpëra, ulje e ndjeshmërisë ose ndjesi dobësie në një këmbë. Ato shpesh lidhen me pozicionin që keni mbajtur gjatë lindjes.
- Çrregullime neurologjike (< 0,01%) si ndjesia e dobësisë , apo konvulsionet lidhen me praninë e anestetikëve lokalë në sistemin e qarkullimit të gjakut.

Raste të jashtëzakonshme:

- Një anestezi e plotë e shtyllës kurrizore (<1/10'000) provokon një anestezi shumë të rëndë të palcës kurrizore. Në këtë rast është e domosdoshme një anestezi e përgjithshme, deri sa efektet e saj të zhduken plotësisht.
- Një dëmtim neurologjik i përhershëm (<1/50'000-1/250'000), nga një hematomë për shkak të shtypjes, një infeksion i thellë apo një traumë e shkaktuar nga gjilpëra, ka nevojë për trajtim të specializuar.

Pyetjet më të shpeshta

- A është e rrezikshme për beben anestezia epidurale?
- Jo. Medikamentet e injektuar veprojnë në nivel lokal dhe nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë ndaj bebes.
- A ndikon në kohëzgjatjen e procesit të lindjes?
- Nuk ka ndikim domethënës dhe nuk i rrit mundësitë për prerje çezariane, por mund të ngadalësojë fazën e dytë të lindjes (daljen e foshnjës).

Kontakt

Shërbimi i Anestezisë, Rruga "Gabrielle-Perret-Gentil" 4 - 1205 Gjenevë, anesthesie.maternite@hcuge.ch
Video informuese në dispozicionin tuaj, në adresën: http://www.hug-ge.ch/anesthesiologie/la-peridurale
Informacion shtesë në adresën: www.sgar-ssar.ch/fr

DAPSI- Albanais•Analgésie péridurale lors d'un accouchement – Juin 2014